# DËSHMI ARKIVI

**A-452255**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | 35-vjeçarja arrestohet për vjedhje dhe bëhet virale për ngjashmërinë e 'frikshme' me divën e muzikës pop, Jennifer Lopez! - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/35-vjecarja-arrestohet-per-vjedhje-dhe-behet-virale-per-ngjashmerine-e-frikshme-me-diven-e-muzikes-pop-jennifer-lopez/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 12:29:36 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 12:25:04 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `6028caa6b43f78938afdd7c7ba05aff22cc33d09291e2f90b718c081a29dc398` |
| TEKSTI | `2dabce6a8a166ecc229679b9942c750870c176aa91e34338f469d6dc91a269e0` |
| PAMJA | `2019ff0452717790cff010f44c8776c7ee32d31eb20ca6c1982fb4a69c845ddb` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4810b79577db4b654b21fc3df6b7202513407d80da2542ad563a6f12be9ce7ac` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `c459fbdf88f453b54a4131a2c6b72ae8533f09b2deef09d60e250bd91e1b553d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4810b79577db4b654b21fc3df6b7202513407d80da2542ad563a6f12be9ce7ac`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA

# 35-vjeçarja arrestohet për vjedhje dhe bëhet virale për ngjashmërinë e 'frikshme' me divën e muzikës pop, Jennifer Lopez!

17 Shtator 2026 | 14:25

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Një 35-vjeçare nga Minesota është bërë virale në rrjetet sociale pas arrestimit për vjedhje, por ajo që tërhoqi më shumë vëmendjen ishte ngjashmëria e saj e madhe me këngëtaren dhe aktoren Jennifer Lopez. Fotografia e arrestimit të Sirena Ann Quast u shpërnda gjerësisht online, pasi përdorues të shumtë vunë re ngjashmërinë e saj me yllin 57-vjeçar.

Quast u arrestua më 30 gusht në Monticello, Minesota, pasi dyshohet se vodhi dy pako me bateri për vegla elektrike, me vlerë totale rreth 580 dollarë. Sipas kallëzimit penal të cituar nga The Watch MN, një punonjës i dyqanit e njohu 35-vjeçaren nga një vjedhje e ndodhur dy ditë më parë dhe njoftoi policinë. Sipas të dhënave të arrestimit, Quast pranoi se kishte marrë bateritë dhe u arrestua nën akuzën për vjedhje. Megjithatë, fotografia e saj pas arrestimit rezultoi të ishte arsyeja kryesore që historia të merrte vëmendje në rrjet.

Shumë përdorues komentuan ngjashmërinë e saj me Jennifer Lopez, ndërsa disa prej tyre e krahasuan në mënyrë humoristike me këngën e famshme "Jenny from the Block". "Për një moment mendova se ishte JLo", shkroi një përdorues, ndërsa një tjetër komentoi: "Është e pabesueshme, duken njësoj". Ngjashmëria mes dy grave u kthye shpejt në objekt batutash në rrjetet sociale. Duke iu referuar këngës "Jenny from the Block", të publikuar nga Jennifer Lopez në vitin 2002, një përdorues shkroi me humor: "Në burg ajo njihet si Jenny nga D-Block". Sirena Ann Quast u lirua më 31 gusht, një ditë pas arrestimit të saj, sipas një raportimi të Daily Mail.

**Shiko në:**

## LAJMI I FUNDIT

- 14:24 **Mbreti Çarls paralajmëron udhëheqësit e IA-së për rreziqet nëse teknologjia bie në duar të gabuara**
- 14:23 **Hamza: Pas vendimit të Hagës, PDK-ja kthehet në Kuvend nëse ka nevojë**
- 14:17 **Eurovision 2027, Irlanda do të bojkotojë konkursin për të dytin vit radhazi**
- 14:11 **Diddy mbetet pa avokat! Firma ligjore kërkon të tërhiqet, pretendon se reperi nuk ka paguar prej 6 muajsh**
- 14:06 **Irani i përgjigjet Merzit: Gjermania po paraqet një narrativë "të shtrembëruar" për luftën dhe programin bërthamor**
- 14:05 **Theu masën e "arrestit në shtëpi" dhe vodhi 16 lokale, arrestohet 34-vjeçari në Tiranë i ndaluar për të njëjtën vepër**

TESTIM

## LAJME TË SUGJERUARA

BOTA | EVROPA
**Mbreti Çarls paralajmëron udhëheqësit e IA-së**

për rreziqet nëse teknologjia bie në duar të gabuara

Mbreti Charles i Britanisë paralajmëroi të enjten drejtuesit e inteligjencës artificiale për rreziqet ekzistenciale që vijnë nga rënia e teknologjisë në duar të gabuara dhe tha se...

14:24 | 17/09/2026

BOTA

**Diddy mbetet pa avokat! Firma ligjore kërkon të tërhiqet, pretendon se reperi nuk ka paguar prej 6 muajsh**

Avokatët e Sean "Diddy" Combs kanë kërkuar zyrtarisht të tërhiqen nga përfaqësimi i tij në një padi për shpifje, duke pretenduar se producenti i muzikës...

14:11 | 17/09/2026

BOTA

**Irani i përgjigjet Merzit: Gjermania po paraqet një narrativë "të shtrembëruar" për luftën dhe programin bërthamor**

Irani ka kundërshtuar deklaratat e kancelarit gjerman Friedrich Merz lidhur me programin bërthamor të Teheranit, aleatët e tij rajonalë dhe situatën në Lindjen e Mesme,...

14:06 | 17/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.